



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh. nr. 108/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A, nenin 109 par 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 9 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Tech Vision” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së” me numër të prokurimit 624-22-2257-5-5-8, iniciuar nga AK- Komuna e Suharekës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 27 prill 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. **Hedhet si jashtëafatshme dhe e palejuar** ankesa e OE “Tech Vizion” me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 108/22, e datës 20 prill 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me paisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së” me numër të prokurimit 624-22-2257-5-5-8, iniciuar nga AK- Komuna e Suharekës.
- II. **I LEJOHET**, autoritetit kontraktues – Komuna e Suharekës që të vazhdoj më tutje,

me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me paisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së” me numër të prokurimit 624-22-2257-5-5-8.

- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën prej njëqind (100 euro) sa ka deponuar me rastin e parashtimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në sistemin elektronik me datë 20 prill 2022, ka pranuar ankesë nga OE “Tech Vizion” me seli në Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me paisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së” me numër të prokurimit 624-22-2257-5-5-8, iniciuar nga AK- Komuna e Suharekës.

Operatori ekonomik “Tech Vizion” me seli në Prishtinë, me datën 06. 04. 2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kundër vendimit të AK-së të datës 01.04.2022. Autoriteti kontraktues me datën 08. 04. 2022 ka refuzuar vendimin e operatorit ekonomik ankues, dhe kundër këtij vendimi për refuzim operatori ekonomik me datën 20 prill 2022 në sistemin e e-prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas analizimit të lëndës, sqaron se ankesa e operatorit ekonomik ankues është jashtë afatit ligjor për parashtrim, për faktin se e njëjta është parashtruar në ditën e dymbëdhjetë (12) pas vendimit të autoritetit kontraktues për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Pra, në pajtim me nenin 108/A dhe nenin 109 par 2 të LPP-së dhe sipas nenit 9 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimi të ankesave

pranë OSHP-së, dhe vlera të tarifave të ankesave palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në OSHP:

2. *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, poashtu sqaron se operatori ekonomik me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka paguar shumën që ka qenë dashur të paguhet konform vlerës së aktivitetit të prokurimit e që ishte 99. 672. 00 euro dhe për këtë është dashur të deponohet tarifa në shumën prej 996. 72 euro, por ka deponuar si pagesë vetëm vlerën prej 100 eurove. Të njëjtit përmes email-it me datën 21 prill 2022 kanë deklaruar se: “Kërkojmë nga ju mirëkuptim për arsye të keqlllogaritjes së afatëve..” por nuk janë përgjigjur për shumën jo të plotë të pagesës. Me këtë rast, OSHP konsideron se tarifa është e mangët dhe nuk është konform Rregullave për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP, F03, nenit 14 par 2 që thotë se: *“Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me 1% të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 5, 000 euro”.*

Duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE “Tech Vizion” me seli në Prishtinë, është e jashtëaftshme dhe e pakompletuar andaj edhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Suharekës

1x1 OE-“Tech Vizion” me seli në Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

